




REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 20/DPK	Nr Prot Br Prot 01-4838/14
Nr. Itaq Broj stranica Nr. pages 03	Data Datum 17-12-2014
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	16/12/2014
REFERENC-Ë:	AKK-DPK-DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Ismet HYSENI Udhëheqës i Prokurimit – Ministria e Shëndetësisë
CC:	z. Gani SHABANI Sekretar i Përgjithshëm – Ministria e Shëndetësisë
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETANI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin: “Furnizim me Mycophenolate (cellcept)”



I nderuari z. HYSENI,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me Tenderin: “Furnizim me Mycophenolate (cellcept)” me nr. prokurimi : 206-14-083-115, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Në lidhje me Tenderin Publik “Furnizim me Mycophenolate (cellcept)” me nr. prokurimi: 206-14-083-115, në mënyrë që të procedohet në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues Ministria e Shëndetësisë, bazuar në nevojën e sajë për Furnizim me barna Mycophenolate Mofetil - Cellcept, ka paraparë aktivitetet prokurimi me Procedurë të Hapur më datë: 13/05/2014;17/06/2014;24/06/2014(ri tenderim);06/11/2014. Në asnjërin nga këto aktivitete, Autoriteti Kontraktues nuk ka mundur ta finalizoj furnizimin me këto barna specifike.

Autoriteti Kontraktues duke synuar që të bëjë furnizim adekuat për të përmbushur nevojat emergjente të pacientëve në përputhje edhe me kërkesat specifike nga stafi profesional, ka qenë i shtyrë për ta ndryshuar procedurën nga "Procedurë e Hapur" në "Procedurë të Negociuar – Një burimore".

Autoriteti Kontraktues, në pajtim me ligjin e LPP-së më datë 01/12/2014 ka njoftuar Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik në lidhje me ndryshimin e procedurës për aktivitetin e prokurimit, nga Procedurë e Hapur, në Procedurë të negociuar pa publikim – Një burimore. Në njoftimin me nr. protokoll 05-6925 drejtuar Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik është dhënë shpjegimi për natyrën specifike të këtij aktiviteti e cila ka shtyrë Autoritetin të ndryshoj procedurën. Në shpjegim thuhet: *"Kërkesa e shoqatës së pos-transplantuarve dhe mjekëve që trajtojnë këta të sëmurë si në Shqipëri, Turqi e Maqedoni që të jepet bari i rekomanduar nga ata, ngase kanë thënë se do të refuzojnë barin që nuk përdoret në regjion apo në Evropë. D.m.th jo të jetë bari i regjistruar por të jetë në qarkullim në këto vende. Edhe tani në klinikën e Nefrologjisë kemi refuzim të barnave që tani furnizohen të sëmurët si: **Takrolimusi** dhe **Ciklosporin-i**. Prandaj ne jemi bazuar në kërkesën e kësaj shoqate të cilën edhe e kemi parashtruar para Kolegjiumit të Klinikës së Nefrologjisë të cilët po ashtu kanë mendimin të respektohen raportet e mjekëve të cilët i trajtojnë"*

Agjencia Kundër Korrupsion është ftuar nga Autoriteti Kontraktues që ta monitoroj këtë procedurë të Negociuar. Më datë 09/12/2014 në Ministrinë e Shëndetësisë është realizuar negociimi në mes Operatorit Ekonomik dhe Autoritetit Kontraktues si dhe Agjencisë Kundër Korrupsion, në cilësinë e vëzhguesit.

Operatori Ekonomik në fillim ofroi çmimin prej 0.49€ për tabletë. Paketimi e barit cellcept ka 100 tableta, ku çmimi total i një pakete ofrohej për 49€. Në respektim të procedurës së negociimit Autoriteti Kontraktues kërkoi nga Operatori Ekonomik zbritjen e çmimit si dhe shkurtimin e afatit të liferimit për shkak nevojës emergjente që kanë pacientët që kanë transplantuar veshkë. Operatori Ekonomik bëri një zbritje të çmimit nga 0.49€, në 0.48€. Nga sasia e kërkuar prej Autoriteti Kontraktues prej 300.000 copë tableta që kapnin shifrën prej 147.000 € është bërë zbritje prej 3000 € dhe vlera e tenderit u zvogëlua në 144.000 €. Operatori Ekonomik premtoi se afati i liferimit do të shkurtohet në pajtim me kërkesat e Autoritetit Kontraktues si dhe për 120 pacientët e kësaj kategorie dhuron falas nga një paketim tableta (100 tableta), në cilësinë e donacionit. Agjencia ka hulumtuar dhe ka ardhur në përfundim se çmimi i barit që është ofertuar nga Operatori Ekonomik, është çmim më i ulët sesa në vendet e rajonit.



Dokumentacionin që posedon Agjencia Kundër Korrupsion, gjegjësisht raportet mjekësore të spitaleve ku është kryer transplantim i veshkës është caktuar bari "Cellcept" si terapi e domosdoshme dhe e përjetshme për pacientë. Raportet e Spitaleve "MEDICALPARK" Antalya, Turqi; "Spitali Amerikan" Tiranë, Shqipëri; "INTERNATIONAL Hospital" Istanbul, Turqi, paraqesin domosdoshmërinë që pacientëve që u kanë bërë transplantimin e veshkës u caktohet terapi me "Cellcept".

Kolegjiumi i Klinikës së Nefrologjisë, i u është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë me shkresën me numër protokoll 90 të datës 16/06/2014 se: *"Nga ky kolegjium rrodhi propozimi se kjo kategori e të sëmurëve duhet të furnizohet me terapi ditore të rregullt dhe me barna që prodhohen ose aplikohen në Evropë ose Amerikë e jo të vendeve të treta. Ne si Kolegjium profesional nuk prejudikojmë kompani, por terapi efektive dhe efektive e cila siguron mbajtjen e organit të transplantuar (veshkës) dhe mos paraqitjen e efekteve anësore negative"*

Një kërkesë tjetër me numër protokoll 05-4277 e datës 23/07/2014 i u është paraqitur Autoritetit Kontraktues nga vet pacientët që kanë bërë transplantimin e veshkës, me të cilën kërkesë, mes tjerash thuhet: *"Produktet që ne i përdorim janë shumë të ndjeshme, andaj kualiteti dhe origjina e prodhimit të tyre është e rëndësishme dhe jetike. Sipas preferencave të ekspertëve të nefrologjisë në Klinikën e Nefrologjisë në QKUK dhe ekspertëve ku neve kemi bërë transplantimin e veshkës (jashtë Kosovës), duhet detyrimisht të përdorim barnat me origjinë, kualitet dhe siguri të standardeve nga prodhuesit në Evropë apo në Amerikë"*

Komisioni vlerësues pas shqyrtimit dhe ekzaminimit të ofertës së Operatorit Ekonomik rekomandoi nënshkrimin e Kontratës me këtë Operator. Më datë 10/12/2014 në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik është publikuar "Njoftim për Dhënie të Kontratës" me të cilin është shpërblyer me kontratë Operatori Ekonomik "MEDITECH".

Agjencia Kundër Korrupsion konsideron se procesi ka qenë i rregullt dhe në pajtim me ligjet në fuqi. Po ashtu, Agjencia konsideron se kërkesat për barin specifik me emërtimin Mycophenolate Mofetil – Cellcept është i domosdoshëm pasi transplantimi i veshkave është tejet i komplikuar dhe duhet trajtim adekuate të këtyre pacientëve.

Autoritetet e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt!